

Material bazik mbi Open Street Map

Permbajtja

1. Cka eshte OpenStreetMap
2. Pse te perdorim OpenStreetMap
3. Pse te kontriboni ne OpenStreetMap
4. Historia e OpenStreetMap
5. Arritjet e OpenStreetMap

Çka është OpenStreetMap

OpenStreetMap (<http://www.openstreetmap.org/>) është projekt që ndërton një databazë të lirë me të dhëna gjeografike nga e gjithë bota. Edhe pse kjo filloj vetëm me futjen e rrugëve në hartë, që tani përfshinë objektet, detrat, plazhet, malet , rrugët për alpinizëm, rrugët për ciklizëm etj..

“OpenStreetMap është hartë globale që zhvillohet nga një komunitet në mbarë botën, është e krijuar nën rregullat e sistemeve të hapura, që për bazë kanë që burimi i informacionit të jetë i lirë të përdoret, modifikohet”.

OpenStreetMap është i ndërtuar nga komunitet e ndryshëm, që mbledhin të dhëna duke vozitur me automobila, biçikleta apo duke ecur nëpër rrugë dhe duke i regjistruar ato duke shfrytëzuar GPS (*Global Positioning System*). Shumica e kontribuesve të OSM janë vullnetarë që punojnë në këtë projekt, gjithashtu organizata dhe qeveri kanë filluar të kontribuojnë në këtë projekt.

OpenStreetMap përdor sistem të ngjashëm si Wiki ku komuniteti mund të shtojnë, editojnë ndryshimet e caktuara në mbarë botën.


OpenStreetMap të dhënat janë të lira për t'u përdorur nga cdokush. Është e realizuar nën licencën që ju lejon juve ta kopjoni, ndryshoni, dhe të ridistribuari të dhënat.

Pse të përdorim OpenStreetMap


Ju mund ta përdorni atë për shumë qështje, duke përfshirë aktivitetet komerciale pa pasur nevojë të paguani për licencë. Ju mund t'i editoni informacionin dhe ta publikoni atë. Obligimi i juaj i vetëm është të shpërndani më të tjerët atë që lejonë të gjithë që të kenë qasje dhe njohuri në OSM. Licenca që shfrytëzohen OSM është *Creative Commons Attribution Share- Alike 2.0 , CC-BY-AA*.

Detajet që mund të futen në OSM nuk janë vetëm rrugë. Të gjithë ata që punojnë janë të lirë të shtojnë çdo objekt gjeografik që ju mund të gjeni, pra njerzit kanë shtuar telefonat publik, vend stacionet e autobusave, parkimet, toaletet publike dhe shumë gjëra të tjera.

Dhe arsyeja më e mirë është nga krahasimi i fotografive të qytetit të Prizrenit.



Fotografi nga Google Map



Fotografi nga OpenStreetMap

Pse të kontriboni në OpenStreetMap

Ndër gjërat e para që dua të shtoj këtu është se në shtetin më të ri në botë Kosova nuk është e ndërtuar në mënyrën më të mirë të mundshme në ndonjë hartë online, mirpo në OpenStreetMap në mënyrë vullnetare deri tani Kosova është mjaft në gjendje të mirë, mirpo që duhet ende shumë të

punohet.

Është ndjenjë e mirë të punohet në OpenStreetMap, krijuesit e OSM në gjithë botën tregojnë mbi atë se kanë gjetur shumë vende të mira që janë në zonën ku jetojnë ata, që nuk e kanë ditur më parë.

Historia e OpenStreetMap

Projekti i OSM ka filluar në Gusht të vitit 2004 kur programeri britanik Steve Coast. Ai shfrytëzonte një program të quajtur GPSDriver, i cili shfrytëzonte në shumë gjëra dhe kërkoi për alternativa tjera mirpo nuk mund të gjente ndonjë gjë tjetër.

Pasi prezantoi iden e tij në iventin për open source në Londër, pa se kishte shumë ide të ngjashme por që nuk kishin fillu të ndërtohej ndonjëra nga idet e më parshme.

Në mars të vitit 2006, u krijua programi i parë “*Desktop*” për OpenStreetMap, JOSM. Është shkruar në Java që lejonë krijimin e hartave offline. Pas pak kohe është krijuar harta e parë me ngjyra dhe harta të renderume që quhet si Osmarender.

Në maj te vitit 2006, ishte iventi i parë për krijimin e hartës në ishullin e quajtur Wight. Ka qenë hera e parë kur shumë krijues të hartave jane takuar drejtpërdrejte. Qe tani ndodhin shumë më shumë aktivitete të tilla në gjithë botën.

(shih foton...)



Fondacioni i OSM është krijuar në Gusht të vitit 2006, që infrastruktura është krijuar nga donacione të ndryshme. Steve Coast ideatori i këtij projekti ka qenë donatori kryesorë në infrastruktur dhe i vetëm për server – ët , emrat e web faqeve, dhe shumë gjëra të tjera.

Në shtator të vitit 2007, *Automotive Navigation Data (AND)*, kompani që i përketë krijimit të hartave, jep donacion të gjithë të dhënat e saj për këtë projekt në Holland. Kjo ka qenë hera e parë që një kompani komerciale ka dhënë.

Arritjet e OpenStreetMap

Për 6 vjet, OpenStreetMap është zhvilluar nga një projekt i vogël nga disa entuziast nga Londra është bërë projekt me resurse globale me qindra shfrytëzues. Për disa shfrytëzues është vetëm hobi , por për disa projekt shumë serioz.

Gjithashtu mund të them se personat që e zhvillojnë OpenStreetMap janë shumë humanitarë që në disa raste qështjet që kërkonin ndihmë te shpejt, të ngritura nga disa persona të caktuara.U ngritën ekipet humanitare që ndihmuan në krijimin e hartave si në:

- Përmbytjet e Shkodrës
- Tërmetit në Gaza, Haiti
- Si dhe në Kebira.